

Gen-I Tirana Shpk

**Raporti i Audituesit të pavarur dhe
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

PËRMBAJTJA:

FAQE

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR MË 31 DHJETOR 2019 4

PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE E TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2019 5

PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2019 6

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2019 7

SHËNIME SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2019 8-29

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar Aksionarëve dhe Drejtimit të Shoqërisë GEN-I Tirana Shpk,

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të GEN-I Tirana Shpk ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2019 dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, dhe shënime të tjera shpjeguese duke përfshirë dhe një përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datë 31 dhjetor 2019 si edhe performancën e saj financiare dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

Baza për opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare" të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës ("BKSNE") dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për informacione të tjera. Informacionet e tjera konsistojnë informacionet që jepen në Raporin e ecurisë së veprimtarisë dhe Raportin e drejtimit të brendshëm, i përgatitur nga drejtimi në përputhje me Nenin 17 dh 19 të Ligjit nr. 25/2018 "Të kontabilitetit dhe pasqyrave financiare", i ndryshuar, por nuk përfshin Pasqyrat Financiare dhe Raportin tonë të Auditimit. Raporti i ecurisë së veprimtarisë dhe Raporti i drejtimit të brendshëm parashikohen të na vihen në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesve. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera, të identifikuar më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë pasaktesi materiale me pasqyrat financiare, apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me anomali materiale. Pasi të lexojmë Raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe Raportin e drejtimit të brendshëm, nëse arrijmë në përfundimin se në këto raporte ka një anomali materiale, atëherë ne duhet të komunikojmë për këtë çështje me personat e ngarkuar me qeverisjen.

Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënimeve shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Shoqërisë, dhe të përdorë parimin kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi ka ose për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveçse sa më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit së auditimit. Gjithashtu, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencat të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të përshtatshme me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e sistemeve të kontrolleve të brendshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vemendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërpreje të aftësisë së Shoqërisë për vazhduar në vijimësi.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë dhe shënimet shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë që të arrihet një paraqitje e drejtë.

Ne komunikojmë me palët e ngarkuara me qeverisjen e Shoqërisë, ku përveçse çështjeve të tjera, komunikojmë edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm që është identifikur gjatë auditimit tonë.

Deloitte Audit Albania Shpk
Deloitte Audit Albania Shpk
Rruga Faik Konica, Ndërtesa nr. 6 Hyrja nr 7, 1010, Tiranë, Shqipëri
Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS): L41709002H



Partner Angazhimi
Audituesi ligjor
Enida Cara


18 maj 2020
Tiranë, Shqipëri

Gen-I Tirana Shpk
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2019


(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

Shënime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018	1 janar 2018	
AKTIVET				
Active Afatgjata				
Aktive Materiale	5	175,059	209,216	262,295
Totali i aktiveve afatgjata		175,059	209,216	262,295
Aktive afatshkurtra				
Llogari të arkëtueshme	6	849,556,910	1,648,367,034	2,270,392,016
TVSH e arkëtueshme	7	531,393,152	564,754,667	433,897,081
Tatim fitimi i arkëtueshëm	23	12,256,629	12,305,168	27,961,916
Parapagime dhe shpenyime të shtyra	8	756,441	20,913,633	19,965,739
Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë	9	12,772,121	10,684,324	28,371,342
Totali i aktiveve afatshkurtra		1,406,735,253	2,257,024,826	2,780,588,094
TOTALI I AKTIVEVE		1,406,910,312	2,257,234,042	2,780,850,389
KAPITALI				
Kapitali i nënshkruar	10	6,050,000	6,050,000	6,050,000
Rezerva rivlerësimi		1,322,598	1,214,065	14,181
Fitime të pashpërndara		52,923,091	63,225,096	198,018,534
Totali i kapitalit		60,295,689	70,489,161	204,082,715
DETYRIMET				
Detyrime afatgjata				
Hua nga kompania mëmë		-	-	210,050,363
Totali i detyrimeve afatgjata		-	-	210,050,363
Detyrime afatshkurtra				
Llogari të pagueshme	11	1,345,209,912	2,167,459,316	2,346,727,919
Detyrime ndaj punonjësve	12	992,840	18,888,418	18,943,850
Të tjera të pagueshme	13	411,871	397,147	1,045,542
Totali i detyrimeve afatshkurtra		1,346,614,623	2,186,744,881	2,366,717,311
TOTALI I DETYRIMEVE		1,346,614,623	2,186,744,881	2,576,767,674
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		1,406,910,312	2,257,234,042	2,780,850,389

Këto pasqyra financiare u aprovuan nga Gen-I Tirana Shpk më datë 30/04/2020 dhe u nënshkruan në emër të saj nga përfaqësuesi ligjor:


Z. Igor Kopriynikar
Përfaqësues ligjor

gen-i 01
GEN-I Tirana Sh.p.k.
Ish-Noll Business Center
Rr. Ismail Qemali, Nr. 27, Tirana, Albania
Unique Identification no.: K81413005A


Ilda Duhanxhiu
Përgatitësit e pasqyrave financiare

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 8 – 29 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Gen-I Tirana Shpk**Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse më 31 dhjetor 2019***(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)*

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 (e riparaqitur)
TË ARDHURAT E SHFRYTËTIMIT			
Të ardhurat nga aktiviteti	14	3,703,981,369	5,548,868,064
Të ardhura të tjera	15	48,610,451	30,892,525
		3,752,591,820	5,579,760,589
SHPENZIME OPERATIVE			
Kosto të shfrytëzimit	16	(3,670,360,729)	(5,478,952,736)
Shpenzime personeli	17	(12,214,894)	(14,280,262)
Shpenzime konsulence	18	(17,149,990)	(16,912,451)
Furnizime dhe shërbime	19	(3,293,972)	(3,286,504)
Shpenzime amortizimi	5	(44,732)	(53,079)
Shpenzime të tjera	20	(945,819)	(34,035,085)
		(3,704,010,136)	(5,547,520,117)
FITIMI NGA AKTIVITETI OPERATIV		48,581,684	32,240,472
Shpenyime financiare neto	21	(166,653)	(475,896)
Humbje neto nga kurset e këmbimit	22	4,267,938	38,917,265
Totali I shpenzimeve financiare neto		4,101,285	38,441,369
FITIMI PARA TATIMIT		52,682,969	70,681,841
(Shpenzimi)/ rregullimi I tatimit	23	(7,959,878)	(15,656,748)
FITIM/(HUMBJA) e vitit		44,723,091	55,025,093
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Fitimi gjithëpërfshirës për vitin		44,723,091	55,025,093

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 8 – 29 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Gen-I Tirana Sh.p.k
Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare më 31 dhjetor 2019

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 (i riparaqitur)
Fitimi përpara tatim-fitimit	52,682,969	70,681,841
<i>Rregullime për:</i>		
Shpenzime amortizimi	44,732	53,079
Ndryshime në Provizione	97,955	337,647
Shpenzime Interesi		475,916
Diferenca nga përkthimi (I kurseve të këmbimit)	(1,639,419)	(17,572,864)
	<u>51,186,237</u>	<u>53,975,619</u>
<i>Fluksi nga veprimtaritë operative para ndryshimeve në kapitalin qarkullues:</i>		
Pakësime/(rritje) në llogari të arkëtueshme	820,129,487	622,024,982
Pakësime/(rritje) në të tjera të arkëtueshme	33,410,054	(116,148,732)
Pakësime/(rritje) në parapagime dhe shpenzime të shtyra	(1,162,171)	-
Rritje/(pakësime) në detytimet nga kontratat	(17,895,578)	-
Rritje/(pakësime) në llogari të pagueshme	(822,249,404)	(179,268,603)
Rritje/(pakësime) në të tjera të pagueshme	14,724	(703,824)
FLUKSE MONETARE NETO		
GJENERUAR NGA/(PËRDORUR NË)		
VEPRIMTARITË OPERATIVE	<u>63,433,349</u>	<u>379,879,442</u>
Interesa të paguar		(524,890)
Tatim fitimi I paguar	(7,959,878)	-
FLUKSE MONETARE NETO		
GJENERUAR NGA/(PËRDORUR NË)		
VEPRIMTARITË OPERATIVE	<u>55,473,471</u>	<u>379,354,552</u>
FLUKSE MONETARE NGA		
VEPRIMTARITË FINANCUESE		
Huamarrje	-	312,317,364
Pagesë huamarrje	-	(519,540,400)
Pagesë dividenti	(55,025,093)	(189,818,534)
PAKËSIM/(RRITJE) NETO E MJETEVE		
MONETARE NGA VEPRIMTARITË		
FINANCUESE	<u>(55,025,093)</u>	<u>(397,041,570)</u>
RRITJE NETO E MJETEVE MONETARE		
DHE EKVIVALENTEVE		
	<u>448,378</u>	<u>(17,687,018)</u>
Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë në fillim të vitit	10,684,324	28,371,342
Efkti i kurseve të këmbimit në Mjete monetare dhe Ekuivalentë	1,639,419	-
Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë në fund të vitit	<u>12,772,121</u>	<u>10,684,324</u>

Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 8–29 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Gen-I Tirana Sh.p.k
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital më 31 dhjetor 2019

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Kapital i nënshkruar i paguar	Rezerva rivlerësimi	Fitime i pashpërndara	Totali
Më 1 Janar 2018	6,050,000	14,181	198,018,534	204,082,715
Diferenca nga përkthimi i kurseve të këmbimit	-	1,199,884	-	1,199,884
Divident i paguar	-	-	(189,818,531)	(189,818,531)
Fitimi për periudhën	-	-	55,025,093	55,025,093
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Fitimi gjithëpërfshirës për vitin	-	-	55,025,093	55,025,093
Më 31 dhjetor 2018 (i riparaqitur)	6,050,000	1,214,065	63,225,096	70,489,161
Diferenca nga përkthimi i kurseve të këmbimit	-	108,533	-	108,533
Divident i paguar	-	-	(55,025,096)	(55,025,096)
Fitimi për periudhën	-	-	44,723,091	44,723,091
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Fitimi gjithëpërfshirës për vitin	-	-	44,723,091	44,723,091
Më 31 dhjetor 2019	6,050,000	1,322,598	52,923,091	60,295,689

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 8-29 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Gen-I Tirana Shpk (në vijim referuar si “Shoqëria”) është e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me datë 13 shkurt 2008 nën formën juridike shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me NIPT K81413005A. Shoqëria është themeluar dhe zotërohet nga aksioneri i vetëm GEN-I d.o.o, Tiranë (Shoqëria Mëmë), e cila ka nënshkruar një kapital prej 6,050,000 Lek i ndarë në 1 kuote me vlerë nominale prej 6,050,000 Lek (2018: 6,050,000 Lek i ndarë në 100 kuota me vlerë nominale prej 60.500 Lek).

Shoqëria ka një degë në Kosovë, GEN-I Tirana – Kosovo Branch për tregtimin e energjisë Republikën e Kosovës, të licensuar nga Zyra Rregullore e Energjise në Kosovë më 29 Dhjetor 2009. Për më shumë referojuni Shënimit 10.

GEN-I Tirana Shpk ka si aktivitet kryesor tregtimin e energjisë me shumicë në rajon, ofrimin e energjisë tek shoqëri dhe tregtues të tjerë dhe blerjen e energjisë nga prodhuesit dhe tregtuesit kryesorë. Aktiviteti i shoqërisë bazohet në liçensat në vijim të lëshuara nga Enti Rregullator i Energjisë në Shqipëri (ERE):

1. Liçensë për veprimtarinë si ofrues i energjisë elektrike tek konsumatori final, fillimisht e lëshuar më 2 Dhjetor 2008 me nr 73, e rinovueshme çdo 5 vite.
2. Liçensë për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike (blerje dhe shitje energjie), fillimisht e lëshuar më 2 Dhjetor 2008 me nr 74, e rinovueshme çdo 5 vite.

Shoqëria e ka filluar aktivitetin e saj tregtar në Shqipëri në fillim të vitit 2010 dhe ka marrëdhënie kontraktuale me shoqëri vendase dhe të huaja, përfshirë shoqërinë Mëmë.

Përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë është Z. Igor Koprivnikar.

Adresa e regjistruar Shoqërisë është: Rruga “Ismail Qemali” nr.27 Ish-Noli Business Center, Tiranë, Shqipëri”.

Numri i punonjësve të Shoqërisë më 31 dhjetor 2019 është 3 (31 dhjetor 2018: 3).

2 Përmbledhje e politikave kryesore kontabël

2.1 Bazat e Përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”), miratuar nga Bordi i Standardeve Nderkombetare të Kontabilitetit.

Ky është viti i parë i zbatimit të SNRF-ve dhe është zbatuar SNRF 1 “Adoptimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për Herë të Parë”. Shpjegime mbi aplikimin e standardit që ndikojnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2018, janë paraqitur në shënimin 4.

Për shkak të ndryshimeve ligjore në Republikën e Shqipërisë (vendimi nr.17 datë 16 Janar 2019), GEN-I Tirana Shpk klasifikohet tashmë si Njësi me Interes Publik (NJIP) sipas kërkesave të ligjit: (i) totali i aktiveve është më i madh se 750 milionë lekë dhe (ii) të ardhurat gjithsej janë më të mëdha se 1 miliardë lekë. Prandaj Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me SNRF-të dhe SNRF 1 “Zbatimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar”.

2 Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Vlerat e përfshira në pasqyrat financiare të Shoqërisë maten duke përdorur monedhën e mjedisit ekonomik kryesor në të cilin operon njësia ('monedha funksionale'). Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, që është dhe monedha funksionale e Republikës së Shqipërisë si edhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.4 Vlerësime dhe gjykime kontabël

Përgatitja e pasqyrave financiare sipas SNRF kërkon ushtrimin e gjykimit në procesin e zbatimit të politikave kontabël. Gjithashtu kërkon nga Drejtimi i Shoqërisë ushtrimin e gjykimit mbi aplikimin e politikave kontabël. Fushat të cilat kërkojnë një shkallë më të lartë gjykimi, që kanë një shkallë të lartë kompleksiteti, apo ato për të cilat supozimet dhe vlerësimet kanë ndikim të madh për pasqyrat financiare, janë pershkruar në shënimet perkatëse të pasqyrave financiare.

2.5 Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit të vijimësisë, i cili supozon se Shoqëria do të jetë në gjendje të shfrytëzojë aktivet e saj dhe shlyejë detyrimet e saj gjatë rrjedhës normale të biznesit.

Zhvillimet e shpejta lidhur me situatën e Covid-19 dhe pasojat socio-ekonomike të tij në Shqipëri dhe në nivel global mund të sjellin nevojën e rishikimit të supozimeve dhe vlerësimeve të bëra me pasoja rregullime materiale në vlerën kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve gjatë vitit të ardhshëm financiar. Në veçanti, drejtimi pret që të preken supozimet dhe vlerësimet e bëra lidhur me përcaktimin e vlerës së TVSH së arkëtueshme. Në këtë fazë, drejtimi nuk është në gjendje të vlerësojë në mënyrë të besueshme ndikimin sepse ngjarjet janë në zhvillim ditë pas dite. Ndikimi afatgjatë mund të ketë pasoja në vëllimet tregtare, flukset monetare, si dhe nivelin e fitimeve. Megjithatë në datën e miratimit të këtyre pasqyrave financiare Gen-I Tirana Shpk vazhdon të përmbushë në kohë të gjitha detyrimet e saj prandaj përdor parimin e vijimësisë për përgatitjen e tyre.

2.6 Zbatimi i Standardeve dhe interpretimeve, të reja ose të rishikuara

• Standarde dhe Interpretime efektive në periudhën aktuale

Në vijim paraqitet një listë e Standarde të reja dhe të ndryshuara, si dhe interpretimeve të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të hyra në fuqi në periudhën e raportimit:

- **SNRF 16 "Qiratë"** (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019);
- **Ndryshimet në SNRF 9 "Instrumentet Financiare"** - Tiparet Parapaguese me Kompensim Negativ (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019);
- **Ndryshimet në SNK 19 "Përfitimet e Punonjësve"** - Ndryshimi i Planit, Reduktimi ose Zgjdhja (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- **Ndryshimet në SNK 28 "Investimet në Shoqëri dhe Sipërmarrje të Përbashkëta"** – Interesat Afatgjatë në Shoqëri dhe Sipërmarrje të Përbashkëta (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).

2 Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

2.6 Zbatimi i Standardeve dhe interpretimeve, të reja ose të rishikuara (vazhdim)

- **Standarde dhe Interpretime efektive në periudhën aktuale (vazhdim)**
- **Ndryshimet në standarde të ndryshme për shkak të projektit “Përmirësimet vjetore të SNRF-ve (cikli 2015-2017)”** me pasoja në eliminimin e mospërputhjeve dhe qartësimin e shprehjes në SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 23 (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- **KIRFN 23 "Pasiguria për Trajtimet e Tatimit mbi Fitimin"** (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).

Zbatimi i këtyre Standardeve, të reja dhe të ndryshuara, si dhe interpretimeve të nxjerra nuk ka pasur ndonjë ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

2.7 Miratimi i Standardeve dhe Interpretimeve të Reja ose të Rishikuara

- **Standarde dhe Interpretime të publikuara por ende jo të përshtatura**

Në datën e autorizimit të pasqyrave financiare të Shoqërisë, janë të publikuara por ende jo efektive standardet dhe interpretimet në vijim, të reja dhe të ndryshuara:

- **SNRF 17 "Kontratat e Sigurimeve"** (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021).
- **Ndryshimet në SNRF 3 “Kombinimi i Bizneseve”** - Përkufizimi i një Biznesi (efektiv për kombinimet e bizneseve për të cilat data e blerjes është më ose pas fillimit të periudhës së parë raportuese më ose pas 1 janarit 2020 dhe blerjes së aktiveve që ndodhi në atë datë ose pas fillimit të asaj periudhe);
- **Ndryshimet në SNRF 9 “Instrumentet Financiare”, SNK 39 “Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja” dhe SNRF 7 “Instrumentet Financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese”** – Reforma për Normën e Interesit Benchmark (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020);
- **Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara" dhe SNK 28 "Investimet në Shoqëri dhe Sipërmarrje të Përbashkëta"** – Shitja ose Kontributi i Aktiveve mes një Investitori dhe Shoqërisë ose Sipërmarrjes së Përbashkët dhe ndryshime të tejsra (data efektive e shtyrë për një periudhë të pacaktuar derisa të përfundojë projekti kërkimor mbi metodën e kapitalit).
- **Ndryshimet në SNK 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare” dhe në SNK 8 “Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësime dhe gabimet”** – Përkufizimi i Matrialitit (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020).
- **Ndryshimet lidhur me Referencat në Kuadrin Konceptual të SNRF-ve** (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020). Shoqëria ka zgjedhur të mos i zbatojë këto Standarde, të reja dhe të ndryshuara, si dhe interpretimeve të nxjerra para datës përkatëse të hyrjes në fuqi.

Kompania ka zgjedhur të mos miratojë këto standarde të reja, ndryshime në standardet ekzistuese dhe interpretim të ri përpara datave të tyre të efektshme.

3 Politikat kryesore kontabël**3.1 Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zërat monetare është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbëhen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit të lekut për 1 njësi të monedhës së huaj në datën e raportimit është paraqitur më poshtë:

	Kursi mesatar 2019	Kursi I raportimit 2019	Kursi mesatar 2018	Kursi I raportimit 2018
ALL / EUR	122.99	121.77	127.58	123.42

3.2 Aktive afatgjata materiale*(i) Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivitet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitet në gjëndje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjëndjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitet.

Shpenzimet kapitale të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitet kur perfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivitet afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3 Politikat e rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

3.2 Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

(ii) Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që Shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në menyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale njihet në pasqyren e rezultatit dhe te te ardhurave gjithëpërfshirëse bazuar në metodën lineare të llogaritjes mbi jetën e dobishme të cdo pjese të aktivitetit, si dhe duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes

Jeta e dobishme e disa kategorive të aktiveve afatgjata vlerësohet si vijon:

Kategoria	Jeta e dobishme
Pajisje zyre	5 vite
Struktura IT dhe pajisje te tjera	5-10 vite

Toka dhe aktivet ne proces nuk amortizohen. Përmirësimet e ambienteve me qira amortizohen për periudhëm më të shkurtër mes afatit të qirasë dhe jetës së tyre të dobishme. Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në cdo datë raportimi. Nuk ka ndryshime ne metodën e mortizimit për vitin 2019.

3.3 Instrumenta financiare

Instrumentet financiare

Shoqëria zotëron vetëm instrumente financiare jo-derivative, që përfshijnë llogaritë e arkëtueshme, mjete monetare dhe ekuivalente, të pagueshmet dhe huatë afatshkurtra. Instrumentet financiare jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus, për instrumente që nuk maten me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kostot e transaksionit të drejtpërdrejtë që i atribuohen. Pas njohjes fillestare, instrumentet financiare jo-derivativë maten si më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen nëse të drejtat kontraktuale të Shoqërisë për flukset e mjeteve monetare nga aktivi financiar mbarojnë ose nëse Shoqëria transferon aktivin financiar një pale tjetër pa mbajtur kontrollin ose në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivitetit.

Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare trajtohen në datën e tregtimit, pra në datën që Shoqëria angazhohet për blerjen ose shitjen e aktivitetit. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet e Shoqërisë të specifikuara në kontratë përfundojnë, shkarkohen ose anulohen.

Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë paratë në dorë, depozitat e mbajtura në thirrje me bankat, investime të tjera afatshkurtra shumë likuide me maturim prej tre muajsh ose më pak, të cilat janë subjekt i rrezikut të parëndësishëm të ndryshimeve në vlerën e tyre të drejtë dhe përdoren nga Shoqëria në menaxhimin e angazhimeve afatshkurtra të saj. Paraja dhe ekuivalentët e saj fillimisht njihen me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e tyre të amortizuar.

Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme fillimisht njihen me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e amortizuar, minus humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka.

3 Politikat e rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

3.3 Instrumenta financiare (vazhdim)

Të pagueshmet

Të pagueshmet fillimisht njihen me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me koston e tyre të amortizuar.

Huatë afatshkurtra

Huatë afatshkurtra fillimisht njihen me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e tyre të amortizuar.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse dëshmitë objektive tregojnë se një ose më shumë ngjarje kanë pasur efekt negativ në flukset monetare të ardhshme të vlerës së aktivit.

Një humbje nga zhvlerësimi në lidhje me një aktiv financiar të matur me koston e amortizuar llogaritet si diferencë midis vlerës së tij kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të parashikuara, të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv.

Aktivet financiare individuale të rëndësishme janë testuar për zhvlerësim në baza individuale. Aktivet financiare të mbetura vlerësohen kolektivisht në Shoqërinë që kanë karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me një aktiv financiar i disponueshëm për shitje i njohur më parë në kapital, transferohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi kthehet në qoftë se kthimi mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ndodh pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Vlera e drejtë

Vlera e drejtë është shuma në të cilën një instrument financiar mund të këmbehet në një transaksion të tanishëm midis palëve të gatshme, përveçse në një shitje të detyruar ose likuidim, si dhe dëshmohet më së miri nga një çmim aktiv i kuotuar i tregut.

Vlera e drejtë e instrumenteve financiare që nuk tregtohen në një treg aktiv (asnjë nga aktivet financiare të Kompanisë nuk tregtohet në një treg aktiv) përcaktohet duke përdorur teknikat e vlerësimit.

(a) Aktivet financiare të mbajtura me kosto të amortizuar

Vlera e drejtë e të gjitha aktiveve financiare konsiderohet të përafrohet me vlerën e tyre kontabël, për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër.

(b) Detyrimet financiare të mbartura me koston e amortizuar

Vlera kontabël e të pagueshmeve dhe huamarrjes afatshkurtër konsiderohet si vlerë e drejtë e përafërt, për shkak të natyrës afatshkurtër të tyre.

3. Politikat e rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

3.4 Parapagimet

Parapagimet maten me kosto minus provizionin për zhvlerësim. Një parapagim klasifikohet si afatgjatë kur mallrat ose shërbimet që lidhen me parapagimin pritet të merren pas një viti ose kur parapagimi lidhet me një aktiv që do të klasifikohet si afatgjatë pas njohjes fillestare. Parapagimet për blerjen e aktiveve transferohen në vlerën kontabël neto të aktivit sapo Shoqëria merr kontrollin e aktivit dhe pret nga ky aktiv përfitime ekonomike të ardhshme. Parapagimet e tjera njihen në fitim ose humbje kur merren mallrat ose shërbimet që lidhen me parapagimet. Nëse ka një tregues se aktivet, mallrat ose shërbimet që lidhen me parapagimin nuk do të merren, vlera e mbartur e parapagimit zhvlerësohet dhe një humbje nga zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje për vitin.

3.5 Kapitali aksionar

Kapitali është njohur në pasqyrat financiare me vlerën nominale.

3.6 Të ardhurat

Njohja e të Ardhurave sipas SNRF 15 (i zbatueshëm që prej 1 Janar 2019)

Të ardhurat nga gjenerimi mbartin karakteristikën e furnizimit të energjisë me një çmim të caktuar. Detyrimi i performancës është të ofrojë një seri mallrash të dallueshme (energja) dhe çmimi i transaksionit është konsiderata që Shoqëria pret të marrë, me çmimin e kontratës. Detyrimi i performancës plotësohet në një moment kohor të caktuar, kështu që të ardhurat njihen për secilën njësi të dorëzuar me çmimin e transaksionit.

Shoqëria ka zgjedhur të zbatojë lehtësitë praktike ku të ardhurat nga energjia për kontratat e saj njihen në shumën e së cilës njësi ekonomike ka të drejtën e faturimit. E drejta për faturimin e energjisë lind kur gjenerohet dhe dorëzohet energjia dhe e drejta për faturim të shumës do të korrespondojë drejtpërdrejt me vlerën tek blerësi.

Informacioni lidhur me politikat kontabël të Shoqërisë të zbatuara në kontratat me klientët paraqitet në Shënimin 4. Zbatimi fillestar i SNRF 15 “Të ardhurat nga Kontratat me Klientët” nuk kishte ndonjë ndikim në Shoqëri krahasuar me SNK 8 “Të Ardhurat”.

Të ardhurat janë fitime të gjeneruara gjatë aktivitetit të zakonshëm të Shoqërisë. Të ardhurat njihen për shumën e çmimit të transaksionit. Çmimi i transaksionit është shuma për të cilën Shoqëria pret të ketë të drejtë në këmbim të transferimit të kontrollit mbi mallrat apo shërbimet e premtuara për një klient, duke përjashtuar shumat e mbledhura në emër të palëve të treta.

Të ardhurat njihen neto nga uljet, kthimet dhe tatimi mbi vlerën e shtuar. Të ardhurat nga ofrimi i shërbimeve njihen në periudhën kontabël në të cilën shërbimet ofrohen.

(i) Marrëveshjet për tranzitim dhe tregtim energjie

Tranzitet ndërkufitare të energjisë elektrike nëpërmjet territorit shqiptar (Rrjeti i Sistemit të Transmetimit) janë bazuar në planet orare të konfirmuara me palët dhe janë njohur kur ndodh tranziti.

(ii) Shërbimet e ndërmjetësimit

Qëllimi i këtyre shërbimeve është ndërmjetësimi në treg për kompaninë mëmë lidhur me aktivitete si tregtimi dhe tranzitimi i energjisë.

Nuk pritet që Shoqëria të ketë ndonjë kontratë ku periudha ndërmjet transferimit të shërbimeve të premtuara ndaj klientit dhe pagesa nga klienti e tejkalon një vit. Për rrjedhojë, Shoqëria nuk rregullon asnjë nga çmimet e transaksionit për vlerën në kohë të parasë.

3. Politikat e rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

3.7 Përfitimet e punonjësve

(i) Kontributet e detyrueshme për sigurime shoqërore

Gjatë ushtrimit të aktivitetit operativ, Shoqëria kryen pagesa periodike për llogari të vet dhe të punonjësve në përputhje me legjislacionin lokal për kontributet shoqërore dhe shëndetësore. Kostot e Shoqërisë janë përfshirë në pasqyrën e fitimit ose humbjes kur ndodhin.

3.8 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe kursi i këmbimit. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes (nëse ka), dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në fitim ose humbje me metodën e interesit efektiv.

3.9 Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shpenzimi i tatim fitimit përfshin tatimin e periudhës dhe tatimin e shtyrë. Tatim fitimi njihet drejtpërdrejt në fitime ose humbje përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen drejtëpërdrejtë në kapital, rast në të cilin edhe tatimi-fitimi njihet në kapital.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, sipas normave tatimore të miratuara në datën e raportimit dhe duke marrë në konsideratë çdo rregullim të tatimit të pagueshëm nga vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë llogaritet mbi diferencat e përkohshme midis vlerës së mbetur të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime fiskale. Tatimi i shtyrë llogaritet me normat e tatimit që priten të aplikohen mbi diferencat e përkohshme në periudhën kur ato rimerren, bazuar në legjislacionin në fuqi deri në datën e raportimit.

Një tatim i shyrë njihet deri në atë vlerë ku mund të pritet që në të ardhmen të ketë fitime të tatueshme të mjaftueshme për realizimin e diferencave të përkohshme. Aktivitetet e njohura nga tatimet e shtyra rishikohen çdo datë raportimi dhe zvogëlohen në rastet kur nuk është më e mundur që përfitimi tatimor përkatës të realizohet.

Trajtimet e pasigurta tatimore

Trajtimet e pasigurta tatimore të Shoqërisë rishikohen nga drejtimi në fund të çdo periudhe raportuese. Detyrimet njihen për trajtimet e tatimit mbi të ardhurat për të cilat drejtimi gjykon se me shume është e mundur sesa jo, që të rezultojë në detyrim tatimor shtesë nëse trajtimet do të kundërshtoheshin nga autoritetet tatimore. Vlerësimi bazohet në interpretimin e ligjeve tatimore që kanë hyre në fuqi ose janë miratuar deri në fund të periudhës raportuese, dhe ndonjë vendim gjykate për çështje të ngjashme. Detyrimet për gjoba, kamatëvonesa dhe tatime të tjera përveç atyre mbi të ardhurat, njihen bazuar në vlerësimin me të mirë të drejtimit për shpenzimet e nevojshme për të shlyer detyrimet në fund të periudhës raportuese. Rregullimet për trajtimet e pasigurta të tatimit mbi të ardhurat, përveç kamatëvonesave dhe gjobave, njihen tek shpenzimi i tatimit mbi të ardhurat. Rregullimet për trajtimet e pasigurta të tatimit mbi të ardhurat në lidhje me interesin dhe gjobat njihen tek shpenzime financiare dhe fitime/(humbje) të tjera, neto, respektivisht.

Gen-I Tirana Shpk

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2019

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

4. Kalimi në raportimin sipas SNRF-ve

Siç paraqitet në Shënimin 2.1 pasqyrat financiare të Gen-I Tirana Shpk janë përgatitur në përputhje me SNRF-të.

Data e kalimit në raportimin sipas SNRF-ve për shoqërinë është 1 Janar 2019. Me disa përjashtime, SNRF 1 kërkon zbatimin në retrospektivë. Ky version u zbatua për përgatitjen e tepricave të bilancit më 1 Janar 2018 sipas SNRF-ve dhe periudhave pasuese të periudhës së parë raportuese sipas SNRF-ve.

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, drejtimi vlerësoi se nuk ka ndryshime të rëndësishme në politikat kontabël dhe metodat e vlerësimit të përdorura në pasqyrat e mëparshme sipas Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) krahasuar me politikat kontabël dhe metodat e vlerësimit sipas SNRF-ve.

Tranzicioni i Pasqyrës së gjendjes financiare

	1 janar 2018		31 dhjetor 2018		
Aktivët	Sipas politikave aktuale kontabël	Efekt i përdorimit të SNRF- ve	Sipas politikave kontabël aktuale	Efekt i përdorimit të SNRF-ve	Sipas SNRF- ve
Aktive Materiale	262,295		209,216		209,216
Totali I aktiveve afatgjata	262,295		209,216		209,216
Llogari të arkëtueshme	2,270,392,016		1,648,367,034		1,648,367,034
TVSH e arkëtueshme	433,897,081		564,754,667		564,754,667
Tatim fitimi I arkëtueshem	27,961,916		12,305,168		12,305,168
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	19,965,739		20,913,633		20,913,633
Asete monetare dhe ekuivalente të tjera monetare	28,371,342		10,684,324		10,684,324
Totali I aktiveve afatshkurtra	2,780,588,094		2,257,024,826		2,257,024,826
Totali I aktiveve	2,780,850,389		2,257,234,042		2,257,234,042

Gen-I Tirana Sh.p.k**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019***(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)***5 Aktive Afatgjata Materiale**

Aktive Afatgjata Materiale më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë të përbëra si më poshtë:

	Pajisje laboratorike	Makina	Mobilje zyre	Pajisje kompjuterike dhe informatike	Totali
Më 1 janar 2018	688,050	116,815	729,147	93,352	1,627,364
Shtesa	-	-	-	-	-
Pakësime	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2018	688,050	116,815	729,147	93,352	1,627,364
Shtesa	-	-	-	-	-
Pakësime	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2019	688,050	116,815	729,147	93,352	1,627,364
Zhvlërësimi i akumuluar					
Më 1 janar 2018	(688,050)	(104,407)	(506,791)	(65,821)	(1,365,069)
Zhvlërësimi i vitit		(3,102)	(44,471)	(5,506)	(53,079)
Pakesime gjatë 2018					
Më 31 dhjetor 2018	(688,050)	(107,509)	(551,262)	(71,327)	(1,418,148)
M					
Zhvlërësimi i vitit		(4,750)	(35,577)	(4,405)	(44,732)
Pakesime gjatë 2019		10,575			
Më 31 dhjetor 2019	(688,050)	-101,684	(586,839)	(75,732)	(1,452,305)
Vlera neto kontabël					
Më 31 dhjetor 2018	-	9,306	177,885	22,025	209,216
Më 31 dhjetor 2019	-	15,131	142,308	17,620	175,059

6. Llogari të arkëtueshme

Llogari të arkëtueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë të përbëra si më poshtë:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Të arkëtueshme nga Shoqëria Mëmë (shënimi 24)	-	186,752,866
Të arkëtueshme nga të tretët	849,556,910	1,461,614,168
Totali	849,556,910	1,648,367,034

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e treta konsistojnë në të drejta nga klientët në lidhje me shitjen e energjisë. Klientët kryesorë vendas janë Kurum International Sh.a, Antea Cement Sha dhe OSHEE Sha. Të arkëtueshmet nga palët e lidhura (shënimi 24) përfshijnë shitjet e energjisë tek shoqëritë e Gen-I Group.

7. Tatimi mbi vlerën e shtuar

TVSH e arkëtueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përbëhet si më poshtë:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Tatim mbi vlerën e shtuar	290,999,054	74,395,823
TVSH për rimbursim	240,394,098	490,394,098
Totali	531,393,152	564,789,921

TVSH për t'u rimbursuar përfshin shumën e TVSH për të cilën Shoqëria ka aplikuar dhe është vlerësuar si e pranueshme për rimbursim. Gjatë vitit 2019 TVSH e rimbursuar ishte 250,000,000 lekë. (viti 2018:75,956,358 lekë).

Tatim mbi vlerën e shtuar përfaqëson TVSH e arkëtueshme për të cilën shoqëria nuk ka aplikuar ende për rimbursim, përfshirë shumën prej 41,942,621 lekë që është kërkuar tashmë dhe bazuar në vendimin e Gjykatës Administrative Tiranë datë 21 Janar 2019, Shoqërisë i takon të rimbursohet, por çështja është në proces gjykimi në Gjykatën e Apelit (deri më 31 dhjetor 2019).

8. Parapagime dhe detyrime të shtyra

Parapagime dhe detyrime të shtyra më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë të përbëra si më poshtë:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Shpenzime të shtyra	756,441	20,913,633
Tëardhura të shtyra	-	-
Totali	756,441	20,913,633

Këto shuma lidhen me të ardhura të rimara nga provizionet e njohura në vitin 2018 lidhur me një çështje gjyqësore. Kjo shumë lidhet me një zhvlerësim të bërë nga shoqëria për rimbursimin e një pagese të vonuar interesi. GEN-I ka apeluar ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për riapelimin e vendimit lidhur me pagesat e vonuara të interesit. Bazuar në vendimin nr. 2271, Gjykata e Apelit ka vendosur të mos pranojë vendimin dhe të rimbursojë Shoqërinë në shumën 30,463,415 lekë. Shuma prej 9,367,052 Lekë u arkëtua më datë 10/5/2019. Shuma ishte provigjionuar plotësisht në vitin 2018.

Gen-I Tirana Sh.p.k
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

9. Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë

Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë të përbëra si më poshtë:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Mjete monetare në bankë:		
<i>Në Euro</i>	5,932,809	8,555,861
<i>Në Lek</i>	6,839,312	2,128,463
Totali	12,772,121	10,684,324

Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë përfshijnë mjetet monetare në llogaritë bankare të cilat përbëhen si vijon: llogari rrjedhëse në Euro dhe Lek pranë bankave Raiffeisen Bank Albania, Raiffeisen Bank Slovenia, OTP & Bank of Kosovo, si dhe një depozitë me afat pranë Raiffeisen bank Albania.

10. Kapitali

Kapitali i regjistruar i shoqërisë është 6,050,000 Lek i ndarë në 1 kuotë me vlerë nominale prej 6,050,000 Lek (2018: 6,050,000 Lek i ndarë në 100 kuota me vlerë nominale prej 60.500 Lek) Shoqëria ka shpërndarë dividendë gjatë 2019 me vlerë 55 milionë Lek tek pronari GEN-I D.o.o. Rezerva nga rivleresimi është krijuar nga konvertimi i llogarive të të ardhurave dhe shpenzimeve nga Euro në Lek të degës në Kosovë. Dega e Kosovës nuk ka patur aktivitet gjatë vitit 2019 dhe vitit 2018. Gjatë vitit 2019 nuk ka realizuar të ardhura (2018: zero) dhe aktivet e degës përfshijnë vetem mjete monetare të cilat më 31 Dhjetor 2019 rezultojnë EUR 105,724 (më 31 Dhjetor 2018: EUR100,819).

11. Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë të përbëra si më poshtë:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Llogari të pagueshme	1,344,515,844	2,167,162,086
Të pagueshme ndaj palëve të treta	694,068	297,230
Totali	1,345,209,912	2,167,459,316

Llogaritë e pagueshme me palët e lidhura përfaqësojnë shumat që Shoqëria i detyrohet shoqërive të grupit për blerjet e energjisë dhe shërbimet e marra prej tyre sipas Marrëveshjes së Shërbimit. Llogaritë e pagueshme me palët e tjera përfaqësojnë shumat kryesore lidhur me blerjen e energjisë dhe për shërbime të tjera të shfrytëzimit operative të blera nga të tretët.

Gen-I Tirana Sh.p.k**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019***(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)***12. Të pagueshme ndaj personelit**

Të pagueshme ndaj personelit më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë të përbëra si më poshtë:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Të pagueshme ndaj personelit	992,840	18,888,418
Totali	992,840	18,888,418

13. Të pagueshme të tjera

Të tjera të pagueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë të përbëra si më poshtë:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	128,483	108,080
Tatim mbi të ardhurat personale	242,288	247,506
Tatimi në burim	41,100	41,561
Totali	411,871	397,147

14. Të ardhura nga shitja e energjisë

Të ardhura nga shitja e energjisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë të përbëra si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shitje energjie brenda vendit	2,998,802,539	3,301,124,733
Shitje energjie jashtë vendit	622,623,311	2,185,802,809
Tarifë Shërbimi	82,555,519	61,940,522
Totali	3,703,981,369	5,548,868,064

15. Të ardhura të tjera

Të ardhura të tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë të përbëra si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura të tjera operative	39,166,748	-
Të ardhura të tjera	9,443,703	30,892,525
Totali	48,610,451	30,892,525

Të ardhurat e tjera operative gjenerohen bazuar në kushtet e ripagimit të marrëveshjes me OSHEE Sha. Të ardhurat e tjera operative gjenerohen bazuar në kushtet e shlyerjes së marrëveshjes me OSHEE Sha.

Gen-I Tirana Sh.p.k
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

16. Shpenzime per aktivitetin e shfrytezimit

Shpenzimet për aktivitetin e shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë të përbëra si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Blerje energjie	3,204,724,746	4,962,241,646
Blerje kapacitete	456,262,226	514,109,057
Te tjera kosto	-	216,009
Tarife licenese	9,373,757	2,386,024
Totali	3,670,360,729	5,478,952,736

17. Shpenzime për personelin

Shpenzimet për personelin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë të përbëra si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Paga	11,381,449	13,489,322
Sigurime shoqerore dhe shendetesore	833,445	790,940
Totali	12,214,894	14,280,262

18. Shpenzime konsulence

Shpenzime konsulence për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë të përbëra si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Komisioni i Menaxhimit	9,384,205	9,919,389
Shërbime fiskale dhe kontabël	4,435,442	2,506,122
Shpenzime ligjore	3,330,343	4,486,940
Totali	17,149,990	16,912,451

19. Furnizime dhe shërbime

Furnizimet dhe shërbimet e marra për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë të përbëra si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Komisione dhe shpenzime bankare	1,173,196	979,885
Shpenzime qiraje	1,165,198	1,212,517
Shërbim dogane	274,000	309,800
Shpenzime komunikimi	641,545	678,754
Shpenzime për kancelari zyre	39,283	105,548
Mirëmbajtje	750	-
Totali	3,293,972	3,286,504

20. Shpenzime të tjera operative

Shpenzime të tjera operative për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë të përbëra si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Gjoha dhe penalitete	-	2,285,370
Komisione dhe taksa doganore	-	2,736
Taksa Bashkiake	131,000	125,600
(Shpenzime) / Provizionime	-	30,801,062
Te tjera shpenzime	814,819	820,317
Totali	945,819	34,035,085

Gjatë vitit 2018 GEN-I ka apeluar vendimin ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për rigjykimin e vendimit lidhur me pagesën e vonuar të interesave (shih shënimin 8). Bazuar në vendimin nr. 2271, Gjykata e Apelit ka vendosur të mos pranojë rigjykimin dhe rimbursimin e shoqërisë në shumën 30,463,415 e cila ishte provizionuar plotësisht në vitin 2018.

21. Shpenzime financiare, neto

Shpenzimet financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018, neto janë të përbëra si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
<i>Shpenzime interesi</i>	(192,076)	(475,916)
<i>Te ardhura nga interesi</i>	25,423	22
Totali	(166,653)	(475,894)

Gjatë vitit 2019 Shoqëria ka përdorur një linjë kreditimi lehtësuese për kapital qarkullues nga Shoqëria Mëmë, e maturuar brenda vitit, me limit kreditimi 7 milionë Euro dhe normë interesi 0.762%.

22. Fitime/humbje neto nga ndryshimi i kursit të këmbimit

Fitime/humbje neto nga ndryshimi i kursit të këmbimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018, neto janë të përbëra si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
<i>Fitime të përealizuara nga kurset e këmbimit</i>	41,410,436	14,245,646
<i>Humbje të përealizuara nga kurset e këmbimit</i>	(38,790,003)	(6,094,647)
	2,620,433	8,150,999
<i>Fitime të realizuara nga kurset e këmbimit</i>	1,647,505	94,422,278
<i>Humbje të realizuara nga kurset e këmbimit</i>	-	(63,656,011)
	1,647,505	30,766,267
Totali	4,267,938	38,917,266

23. Shpenzimi i tatim-fitimit

Bazuar në legjislacionin shqiptar norma e tatimit mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 është 15% (2018: 15%).

Deklaratat tatimore dorëzohen çdo vit, por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qëllime tatimi konsiderohen vetë-deklarime deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe lëshojnë vleresimin final.

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 Shoqëria rezultoi me një fitim të taksueshëm për qëllime kontabël dhe fiskale (2018: njësoj).

Shpenzimi i tatim-fitimit përfshin si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzimi i tatim-fitimit të periudhës	7,959,878	15,656,748
Shpenzim tatim-fitimi per periudhen	7,959,878	15,656,748
Fitimi/ (humbja) i periudhës	52,995,284	70,956,199
Rregullime për periudhat tatimore te vitit me pare		
<i>Shpenzimi i tatim-fitimit të periudhës</i>	<i>15%</i>	<i>15%</i>
Tatimi mbi fitimin me normën e aplikueshme	7,949,293	10,643,430
Rregullime për periudhat tatimore të mëparshme nga autoritetet tatimore		
Shpenzime të pazbritshme		
	10,585	5,013,318
Tatim fitimi	7,959,878	15,656,748

Rakordimet e tatim-fitimit efektiv janë si më poshtë:

Tatim-fitimi i arkëtueshëm më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përbëhet nga sa më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Më 1 janar	12,305,168	27,961,916
Parapagime për tatim-fitimin	7,911,339	
Shpenzimi i tatim-fitimit për vitin	(7,959,878)	(15,656,748)
Totali	12,256,629	12,305,168

24. Transaksionet me palë të lidhura

Një transaksion me palët e lidhura është një transferim i burimeve, shërbimeve apo detyrimeve midis palëve të lidhura, pavarësisht nëse është caktuar një çmim. Një palë është e lidhur me një njësi ekonomike nëse kontrollon, kontrollohet nga, ose është nën një kontroll të përbashkët me njësinë ekonomike; ka një interes në njësinë ekonomike që i jep asaj influencë të konsiderueshme mbi njësinë; ose pala ushtron një kontroll të përbashkët mbi njësinë; pala është një pjesëmarrje e njësisë ekonomike; pala është një sipërmarrje e përbashkët në të cilën njësi ekonomike është një sipërmarrës; ose një nga anëtarët e personelit drejtues të njësisë apo të shoqërisë mëmë të saj (duke përfshirë familjarë të afërt të ndonjërit prej individëve të referuar më sipër). Kontrolli është fuqia për të drejtuar politikatat financiare dhe operative të një entiteti në mënyrë që të marrë përfitime nga veprimtaritë e saj. Kontrolli supozohet të ekzistojë, kur prindi, zotëron drejtpërdrejt ose tërthorazi më shumë se gjysmën e të drejtave të votës të filialit.

Në datën e raportimit financiar, shumat dhe transaksionet e mëposhtme u korrespondojnë palëve të lidhura:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të arkëtueshme nga Gen-I d.o.o		
<i>Nga shitja e energjisë</i>	-	186,752,866
Të pagueshme për Gen-I d.o.o		
<i>Nga blerje energjie</i>	1,033,569,172	1,912,212,048
<i>Nga huatë</i>	-	-
<i>Volumi i transaksioneve</i>		
<i>Gen-I Slovenia</i>		
<i>Të ardhurat</i>		
<i>Të ardhura nga shitja energjisë</i>	489,316,328	2,094,650,549
<i>Të ardhura të tjera nga shitja</i>	24,964,600	32,283,641
<i>Interesa per Gen-I d.o.o</i>	-	-
<i>Kostot</i>		
<i>Shpenzime energjie</i>	2,423,517,983	2,281,694,204
<i>Shpenzime kapacitete</i>	416,831,956	478,060,100
<i>Të tjera shpenzime për Gen-I d.o.o</i>	9,384,205	9,919,389
	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
<i>Kompensimi i Drejtuesve Kryesore</i>		
<i>Shpenzime page</i>	1,800,000	1,800,000

25. Menaxhimi i riskut financiar

Bordi Drejtues i Shoqërisë ka përgjegjësinë kryesore për krijimin dhe mbikqyrjen e një kuadri të menaxhimit të riskut për Shoqërinë. Bordi drejtues ka ngritur një komitet të menaxhimit të riskut që është përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të menaxhimit të riskut për Shoqërinë.

Politikat e menaxhimit të riskut të Shoqërisë synojnë: të identifikojnë dhe analizojnë risqet që ndesh Shoqëria; të vendosin kufij të përshtatshëm të riskut; të kontrollojnë dhe monitorojnë risqet dhe repektimin e kufijve të risqeve të vendosura. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të risqeve rishikohen rregullisht për të pasqyruar ndryshimet në kushtet e tregut dhe aktivitetet e shoqërisë. Gjithashtu Shoqëria përmes trajnimeve, standardeve dhe procedurave të menaxhimit, synon të mbajë një mjedis të disiplinuar dhe bashkëveprues nv të cilin të gjithë punonjësit të kuptojnë rolet dhe detyrat e tyre.

Shoqëria është e ekspozuar ndaj risqeve në vijim lidhur me përdorimin e instrumentave financiarë:

- risku i kreditit
- risku i likuiditetit
- risku i tregut (risku i monedhës, risku i normës së interesit, risku i çmimit të mallit)

Risku i kreditit

Instrumentet financiare, të cilat mund ta ekspozojnë Shoqërinë ndaj riskut të kreditit, konsistojnë kryesisht në llogari të arkëtueshme të tjera të arkëtueshme dhe mbajtja e arkës. Risku i kreditit për Shoqërinë menaxhohet duke vendosur mjetet monetare dhe ekuivalentë të tjerë në institucione financiare të cilësisë së lartë.

Risku maksimal i kreditit ndaj të cilit është e ekspozuar Shoqëria është si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
<i>Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë</i>		
Gjendje, jo të kufizuara apo të zhvlerësuara	12,772,121	10,684,324
Gjendje, jo të kufizuara por të zhvlerësuara sipas SNRF 9	-	-
Zhvlerësimi	-	-
Total	12,772,121	10,684,324
<i>Llogari të arkëtueshme</i>		
Gjendje, jo të kufizuara apo të zhvlerësuara	849,556,910	1,648,367,034
Gjendje, jo të kufizuara por të zhvlerësuara sipas SNRF 9	-	-
Zhvlerësimi	-	-
Total	849,556,910	16,483,670,344

Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të kreditit në biznesin e saj, sepse është e mundur që klientët të mos mundën të shlyejnë detyrimet e tyre financiare. Shoqëria e strukturon nivelin e riskut të kreditit duke vendosur limite në sasinë e riskut që pranon nga kundërpartitë si dhe duke diversifikuar portofolin e saj të kreditit. Limitet në nivelin e riskut të kreditit aprovohen në mënyrë të rregullt nga Menaxhimi. Këto risqe monitorohen në mënyrë të rregullt si dhe janë subjekt i rishikimeve vjetore apo rishikimeve më të shpeshta.

Gen-I Tirana Sh.p.k**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019***(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)***25. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)****Risku i likuiditetit**

Shoqëria nuk është e ekspozuar në mënyrë të rëndësishme ndaj rrezikut të likuiditetit. Detyrimet financiare të saj janë të kufizuara vetëm në huamarrje ndaj Shoqërisë mëmë.

Shumat e paraqitura më poshtë janë aktivet dhe detyrimet financiare të Shoqërisë në bazë të maturimit të tyre.

31 Dhjetor 2019	Më pak se 6 muaj	6 deri në 12 muaj	Më shumë se një vit	Totali
<i>Aktive financiare</i>				
Llogari të arkëtueshme	849,556,910	-	-	849,556,910
TVSH e arkëtueshme	240,394,098	41,942,621	249,056,433	531,393,152
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	756,441			756,441
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	12,772,121	-	-	12,772,121
Totali	1,103,479,570	41,942,621	249,056,433	1,394,478,624
<i>Detyrime financiare</i>				
Llogari të pagueshme	(1,345,209,912)		-	(1,345,209,912)
Te pagueshme ndaj punonjësve	(992,840)		-	(992,840)
Tjera të pagueshme	(411,871)	-	-	(411,871)
Total	(1,346,614,623)	-	-	(1,346,614,623)
Pozicioni neto i likuiditetit	(243,135,053)	41,942,621	249,056,433	47,864,001
31 Dhjetor 2018	Më pak se 6 muaj	6 deri në 12 muaj	Më shumë se një vit	Totali
<i>Aktive financiare</i>				
Llogari të arkëtueshme	1,648,367,034			1,648,367,034
TVSH e arkëtueshme	120,000,000	130,000,000	314,754,667	564,754,667
Parapagime & shpenzime të shtyra	20,913,633			20,913,633
Mjete monetare dhe ekuivalente	10,684,324			10,684,324
Totali	1,799,964,991	130,000,000	314,754,667	2,244,719,658
<i>Detyrime financiare</i>				
Llogari të pagueshme	(2,139,467,616)	(27,991,700)	-	(2,167,459,316)
Tjera të pagueshme	(3,880,812)	-	(15,404,753)	(19,285,565)
Total	(2,143,348,428)	(27,991,700)	(15,404,753)	(2,186,744,881)
Pozicioni neto i likuiditetit	(343,383,437)	102,008,300	299,349,914	57,974,777

25. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)**Risku i kursit të këmbimit**

Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të kursit të këmbimit kryesisht në lidhje me pagesat që kryen ndaj furnitorëve si dhe Shoqërisë Mëmë. Kontratat e lidhura me furnitorët dhe me Shoqërinë Mëmë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 janë të emëruara në Euro. Shoqëria nuk ka përdorur instrumente derivative që të mbrohet ndaj ekspozimit të normës së interesit dhe kurseve të këmbimit.

Aktivitet dhe detyrimet e Shoqërisë sipas valutës në 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 janë si më poshtë:

31 Dhjetor 2019	EUR	ALL	Totali
<i>Aktive financiare</i>			
Llogari të arkëtueshme	840,295,182	9,261,728.00	849,556,910
Llogari të tjera të arkëtueshme	-	-	-
Mjete monetare dhe ekuivalente të tjerë	5,845,900	6,926,221	12,772,121
Totali	846,141,082	16,187,949	862,329,031
<i>Financial liabilities</i>			
Llogari të pagueshme dhe të tjera	(1,333,397,961)	(11,811,951)	(1,345,209,912)
Total	(1,333,397,961)	(11,811,951)	(1,345,209,912)
Pozicioni neto	(487,256,879)	4,375,998	(482,880,881)
31 Dhjetor 2018			
<i>Aktive financiare</i>			
Llogari të arkëtueshme	1,648,367,034		1,648,367,034
Llogari të tjera të arkëtueshme	-	-	-
Mjete monetare dhe ekuivalente të tjera	8,555,861	2,128,463	10,684,324
Totali	1,656,922,895	2,128,463	1,659,051,358
<i>Financial liabilities</i>			
Llogari të pagueshme dhe të tjera	(2,167,127,166)	(332,150)	(2,167,459,316)
Total	(2,167,127,166)	(332,150)	(2,167,459,316)
Pozicioni neto	(510,204,271)	1,796,313	(508,407,958)

Analiza e sensitivitetit të riskut nga kursi i këmbimit

Analiza e mëposhtme e riskut nga kursi i këmbimit është përcaktuar bazuar në ekspozimin ndaj riskut të kursit të këmbimit në datën e raportimit si dhe ndryshimet e ndodhura në fillimin e vitit financiar dhe të mbajtura konstante gjatë gjithë periudhës së raportimit. Më poshtë paraqitet një përcaktim i efekteve të ndryshimit në kursin e këmbimit në fitimin pas tatimit, duke i mbajtur të gjithë elementet e tjerë konstantë. Tabela tregon fitimin (humbjen) në Lek kur monedha Euro zhvlerësohet me 10% ndaj monedhës së Lekut.

	EUR (2019)	EUR (2018)
Euro zhvlerësohet me 10 %	48,725,688	51,020,427
Euro rivlerësohet me 10 %	(48,725,688)	(51,020,427)

26. Angazhime, garanci dhe detyrime të mundshme

Gjatë aktivitetit normal të biznesit, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime të ndryshme nga të tretë. Veçanërisht legjislacioni tatimor dhe doganor shqiptar i cili u miratua ose u miratua në mënyrë thelbësore në fund të periudhës së mëparshme të raportimit, i nënshtrohet interpretimeve të ndryshme kur zbatohet për transaksionet dhe aktivitetet e Shoqërisë. Si pasojë, pozicionet tatimore të marra nga drejtimi dhe dokumentacioni zyrtar që mbështesin pozicionet tatimore mund të kundërshtohen nga autoritetet përkatëse. Periudhat fiskale mbeten të hapura për t'u rishikuar nga autoritetet në lidhje me taksat për pesë vite kalendrike para vitit të rishikimit.

Me 31 dhjetor 2019, Shoqëria rezulton të jetë e përfshirë në pretendime të ngritura nga palë të treta apo çështje ligjore. Drejtimi mendon se pozicioni financiar i Shoqërisë nuk do të ndikohet negativisht në qoftë se kjo e fundit do të përballet me ndonjë pretendim të ngritur nga një palë e tretë.

27. Ngjarje pas datës së raportimit

Në dhjetor 2019, një shpërthim i një lloji të ri të koronavirusit, COVID-19, u shfaq në Wuhan, Kinë. Brenda disa javësh, përkundër përpjekjeve për ta mbajtur virusin në Kinë që përfshinte mbyllje të gjerë të qyteteve dhe bizneseve, numri i të infektuarve u rrit ndjeshëm, dhe përtej kufijve të Kinës, përfshirë Shqipërinë. Më 11 mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë njoftoi një situatë pandemike për shkak të emergjencës globale të shkaktuar nga shpërthimi i COVID 19. Përhapja e koronavirusit ende po evoluon dhe efektet e saj mbeten të panjohura. Për detaje të mëtejshme, ju lutemi referojuni Shënimit 2.5 "Vijimësia".

Nuk ka asnjë ngjarje tjetër përveç sa më sipër, të mëpasshme pas datës së raportimit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.